34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të përealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumatat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrimi;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësitë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 615-24-682-5-2-1/C995

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit duhet të jetë 10% e totalit të kontratës me vlefshmëri prej 390 ditësh duke filluar nga data e nënshkrimit EUR. Shuma e siguris së ekzekutimit është 59445.00€ Dt.14/05/2024 deri më 08/06/2024
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë

Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 5 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës
	17.2	Kontrata hyn në fuqi nga data e nënshkrimit ndërsa Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë sipas planit dinamik e që është 360 ditë.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është Do të caktohet nga ZKA Brenda tre ditësh
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: N/A
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: N/A
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 3 vite
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet ne Gjykatën Themelore ne Prishtinë – Dega Podujeve në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

SHKOLLA FILLORE "HASAN RAMADANI" - PODUJEVË

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

faza: **ARKITEKTURA**

PUNËT PËRGATITORE

1.1 Punët parapërgatitore					
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi për Njësi me TVSH/€:	Çmimi Total me TVSH/€:
1.1.2	Pastrimi i gjerë i truallit prej shkurreve dhe heqja e shtresës së humusit h=20 cm në të sipërfaqen e truallit, dhe bartja e mbeturinave deri në deponinë e paraparë.	Komplet	1	1000	1000.00
1.1.3	Rrethimi/sigurimi i truallit për ndërtim dhe shenjzimi informativ.	Komplet	1	1500	1500.00
1.1.4	Pozicionimi gjeodezik dhe shenjzimi i objektit për ndërtim.	Komplet	1	350	350.00
1.1.5	Ndërtimi i përkohshëm i rrjetit të ujësiellësit dhe kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndriçimit të kantierit, si dhe objekteve të përkohshme, (toaletëve dhe zyres mobile).	Komplet	1	500	500.00
1.1.6	Ekzaminimi i materialeve para dhe pas vuarjës në vepër të tyre si psh. betonit, armatures dhe elementeve të tjera për shqyrtim si dhe prejardhjen e tyre. Kontraktori është i obliguar që të sjellë ateste paraprake dhe preardhjen e materialit para fillimit të punimeve.	cope	20	50	1000.00
Pozicioni total 1.1:					4,350.00

Pozicion total 1:

4,350.00

PUNËT E DHEUT

2.1 Punët e dheut, zhavorrit dhe rërës					
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi për Njësi me TVSH/€:	Çmimi Total me TVSH/€:
2.1.1	Gërmimi i gjerë i dheut të kategorisë (GFS ,GW) me makinë për fondimin e themeleve shiritore ,bartja e dheut bëhet deri në deponinë e paraparë.	m3	770	4	3080.00
2.1.2	Ngjeshja dhe planifikimi i dheut në tër sipërfaqen ku do të punohen themelet, me ngjeshje $\pm 0,05$	m2	1100	0.5	550.00
2.1.3	Blerja, furnizimi, transporti i zhavorit 0-63mm dhe ngjeshja deri sa të arrihet moduli i deformimit 80KN/m2 të shtresave të tamponit nën themelet shiritore me trashësi h=20+10 cm.	m3	92	15	1380.00
2.1.4	Blerja, furnizimi, transporti i zhavorit të perzier për mbushje të kthinave ndërmjet themeleve shiritore. Ngjeshja të bëhet deri sa të arrihet moduli i deformimit 80KN/m2.	m3	260	15	3900.00
2.1.5	Blerja, furnizimi, transporti i zhavorit 0-63mm dhe ngjeshja deri sa të arrihet moduli i deformimit 80KN/m2 të shtresave të tamponit nën pllaken e Perdheses me trashësi h=20 cm.	m3	140	15	2100.00
2.1.6	Furnizimi, transportimi dhe palimi i zhavorrit të lumenjeve 16-63mm në gjerësi 30cm, për drenazhim përreth mureve të objektit.	m3	55.00	15	825.00
Pozicioni total 2.1:					11,835.00

Pozicioni total 2:

11,835.00

PUNËT E BETONIT dhe ARMATURES

3.1 Punët e betonit dhe armatures					
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi për Njësi me TVSH/€:	Çmimi Total me TVSH/€:
3.1.1	Furnizimi transporti dhe betonimi I themeleve shiritore me dimensione sipas projektit duke perfshi edhe cokllen e themelit deri ne nivelin e siperm te pllakes se perdheses. Punimi te behet nga betonit I armuar I klases C25/30. Ne llogari te merret edhe pahija e nevojshme.	m ³	290.00	85	24650.00
3.1.2	Furnizimi transporti dhe betonimi pllakes se dyshemese/perdheses me trashesi 20cm dhe themel pllakes tek pjesa e hollit si ne projekt 40cm. Punimi te behet nga betonit I armuar I klases C25/30 I cili duhet te permbaj aditiv ne jo ujeperkueshmeri. Ne llogari te merret edhe pahija e nevojshme. Te merret mostra dhe perveq testimi ne shtypje te behet edhe testimi ne ujeperkueshmeri. Ne kete llogari gjithashtu jane te perfshira edhe shkallet e disnivelit (3 shkalle) ne perdhese.	m ³	220.00	85	18700.00
3.1.3	Furnizimi transporti dhe betonimi I mureve masive rreth kaldase dhe mureve ne hyrje te objektit me trashesi 20 dhe 25cm. Punimi te behet nga betonit I armuar I klases C25/30. Ne llogari te merret edhe pahija e nevojshme.	m ³	26.00	85	2210.00
3.1.4	Furnizimi, transporti dhe betonimi i shtyllave të veçuara te dimenzioneve te ndryshme dhe pelhurave nga betoni i armuar C 30/37 I cili duhet te permbaj aditiv ne jo ujeperkueshmeri. Dimensionet e shtyllave te punohen sipas projektit (disa shtylla ne gabarit te objektit kane forme katerkendeshe jo te rregullt pasi qe perbejn element arkitektonik ne fasade). Ne llogari te merret edhe pahia e nevojshme.	m ³	72.00	90	6480.00
3.1.5	Furnizimi transporti dhe betonimi I pllakave monolite (pllakes mbi perdhese dhe pllakes mbi kat) nga betoni I armuar C25/30 me trashesi 20cm. Ne pozicion eshte perfshi edhe sasia e betonit te trajeve te integruara. Ne llogari jane perfshi edhe shkallet ne dy anet e galerise me gjersi te krahut 150cm si dhe tere pahija e nevojshme.	m ³	395.00	85	33575.00
3.1.6	Furnizimi, transportimi dhe betonimi I mureve te atikes me lartesi 100cm ne forme te pjerrret pasi qe perbejn detal arkitektonik ne fasade nga betoni I armuar C25/30 me trashesi 20cm ne fillim te murit ndersa 40cm ne mbarim te lartesis se murit Ne llogari te merret edhe pahija e nevojshme.	m'	45.00	50	2250.00

3.1.7	Furnizimi, transportimi, prerja, lakimi dhe vendosja e armaturës e të gjitha pozicioneve në të gjithë objektin sipas detajeve të armimit nga llogaria statike, klasa e armatures B 500 .	kg	108000.00	0.98	105840.00
Pozicioni total 3.1:					193,705.00

Pozicioni total 3:	193,705.00
---------------------------	-------------------

PUNËT E MURATIMIT dhe SUVATIMIT

PUNËT E MURATIMIT dhe SUVATIMIT						
4.1	Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi për Njësi me TVSH/€:	Çmimi Total me TVSH/€:
4.1.1		Furnizimi, transportimi dhe muratimi i mureve të jashtme dhe të brendshme që punohen me blloqe të argjilës gjysem giter me dimensione 19x19x25cm me llaq vazhdues në përpjesë 1:1:3, me të gjitha punët paraprake. Në llogari të meren edhe arkitrajt e betonit mbidyer.	m ³	355.00	60	21300.00
4.1.2		Furnizimi, transportimi dhe muratimi i mureve të brendshme me blloqe poroze 10x20x60cm me ngjites perkates dhe me të gjitha punët paraprake. Llogaritja të behet per m2 te murit te punuar.	m ²	37.00	100	3700.00
4.1.3		Furnizimi, transportimi dhe muratimi i mureve të brendshme ze izoluese me keto shtresa (bllok poroz 15cm - lesh guri 10cm - bllok poroz 15cm) blloqe poroze 15x20x60cm dhe ngjites perkates dhe me të gjitha punët paraprake. Llogaritja të behet per m2 te murit te punuar.	m ²	90.00	50	4500.00
4.1.4		Furnizimi, transportimi dhe muratimi i oxhakut nga kaldaja në perberje prej bllokut të betonit 45x45cm, oxhakut të shamotit diameter 18cm dhe shtreses izoluese ndermjet tyre. Në llogari të meret elementi për kyqje dhe pastrim të oxhakut, materiali lidhes I blloqeve si dhe kapakut të oxhakut mbi kulm. Verejtje, oxhaku mbi kulm duhet të termoizolohet dhe hidroizolohet.	m'	8.00	55	440.00
4.1.5		Furnizimi, transportimi dhe muratimi i ventilimeve nga blloqet e argjilës me dimensione 20/25cm. Në llogari të meret elementi për kyqje dhe pastrim të ventilimit, materiali lidhes I blloqeve si dhe kapakut të ventilimit mbi kulm. Verejtje, oxhaku mbi kulm duhet të termoizolohet dhe hidroizolohet.	m'	32.00	20	640.00
4.1.6		Suvatimi i mureve të brendshme dhe pllafonit në dhoma, koridore, nyjet sanitare me llaq të çimentos dhe gelqeres në shtrese me trashesi prej t=2.5 cm dhe shtrese paraprake qumshti të çimentos. Në cmim duhet të llogariten edhe kendet metalike të pjesa e deryve, dritareve dhe në pjesen kendore të mureve të koridorit.	m ²	3780.00	5.5	20790.00
4.1.7		Gletimi i mureve dhe pllafoneve "te terura" në dy shtresa si dhe ngjyrosja me policolor gjysem të plastifikuar të bardhe dhe sipas udhezimeve të mbiqkyresit. Vetëm sipërfaqet që duhet të mvëshen me pllaka qeramike nuk duhet të punohen me këte pozicion,	m ²	3150.00	5	15750.00
Pozicioni total 4.1:					67,120.00	

Pozicioni total 4:	67,120.00
---------------------------	------------------

PUNËT E KULMIT

PUNËT E KULMIT					
5.1	PUNËT E KULMIT				
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi për Njësi me TVSH/€:	Çmimi Total me TVSH/€:
5.1.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i izolimit termik dhe krijimi i ramjeve re siperfaqes mbi pllake te katit ne drejtim te ujembledhsave me keto shtresa (stiropor EPS N4 10+5cm, PVC folie, shtrese rrafshuese me rampje 1-2% nga betoni i thate t min=5cm). Ne qender te kulmit ku duhet te jete pika me e larte, stiropolli te punohet 10+5, ndersa ne skaje gradualisht mund te bije ne 5+5.	m ²	915.00	19	17385.00
5.1.2	Furnizimi transporti dhe punimi hidroizolimit te kulmit te rrafshet duke filluar me lyerje paraparke baze me masi bituliti dhe 3 shtresa terthore izolimi me flake nga 0.6mm (cosmofin G ose ngjashem). Shtresa e fundit perpos shtreses se gomes, duhet te permbaj edhe nje shtrese alumini ne mes si dhe e zallosur nga ana e siperme. Pjese perberese te ketij pozicioni jane edhe te gjitha pikat delikate te ujembledhsave. Muri i atikes poashtu duhet te hidroizolohet deri ne nivelin me te larte te tij, poashtu edhe oxhaqet dhe ventilimet. Pasi te perfundoj egzekutimi i hidroizolimit, te behet testimi i tij ne vend ne jo uje-perkueshmeri me sasi te ujit h=20cm dhe kohezgjatje 72 ore.	m ²	1150.00	19.5	22425.00
5.1.3	Furnizimi transporti dhe punimi i hidroizolimit te koritave te gjelbrimit mbi kulm me dimensione 60x300cm. Koritat te hidroizolohen me te njejtat karakteristika si pozicioni 5.1.3. nga anet vertikale dhe horizontale. Pasi te perfundoj egzekutimi i hidroizolimit, te behet testimi i tij ne vend ne jo uje-perkueshmeri me sasi te ujit h=20cm dhe kohezgjatje 72 ore.	cope	6.00	150	900.00
5.1.4	Furnizimi transporti dhe punimi/mbrojtja e hidroizolimit vertikal ne muret e atikes dhe oxhaqe e ventilime me ane te shtreses termoizoluese XPS - stiroduer 3cm. Ne kete pozicion te perfshihet edhe ngjitesi perkates si dhe rrjeta PVC dhe ngjitesi siper tij.	m'	185.00	15	2775.00
5.1.5	Furnizimi, transportimi dhe montimi i olluqeve vertikale me të gjitha elementet përcjellëse prej llamarinës së plastifikuar të tipit "LINDAB" ose të ngjajshme .Olluqet kanë formë rrethore me gjerësi d=100mm. Matja bëhet në m' duke u llogaritur si pozicion i përfunduar së bashku me brylat dhe fontanat. Ne cmime te perfshihet demolimi dhe adaptimi i ullukeve ekzistues .	m'	102.00	8.00	816.00
5.1.6	Furnizimi transporti dhe shtrirja e zhavorit te lumit per drenazhe fraksion 16-63mm mbi tere siperfaqen e kulmit me trashesi prej 15-20cm qe ka per qellim mbrojtjen e hidroizolimit nga te gjith faktoret atmosferik.	m ³	170.00	15	2550.00
5.1.7	Furnizimi transporti dhe montimi i llamarines ne forme U mbi tere murin e atikes me gjersi variable sipas trashesise se murit te atikes. Profili i llamarines eshte 60-120cm. Llamarina te jete 0.9mm si dhe antracid nga ana e jashtme. Ne kete pozicion jane te perfshira edhe profilet e metalit ne ta cilat ngjiter llamarina ne goja dhe pa bulona nga siper.	m'	163.00	16	2608.00
Pozicioni total 5.1:					49,459.00

Pozicioni total 5:

49,459.00

PUNËT E NIVELIZIMIT DHE DYSHEMESHË

6.1 PUNËT E NIVELIZIMIT DHE DYSHEMESHË					
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi për Njësi me TVSH/€:	Çmimi Total me TVSH/€:
6.1.1	Furnizimi, transportimi dhe punimi i dyshemese ne te gjitha hapsirat e brendshme ne perdhese dhe ne kat me keto shtresa: Stiropor I presuar N4 t=2x3cm, PVC folie dhe beton I thate ne perpjese 1:3 me trashesi t=5 cm.	m ²	1505	9	13545.00
6.1.2	Furnizimi, transporti dhe punimi i dyshemese nga EPOXY ne shtresat perkatese, nivelant dhe epox ne nuanca te lehta te zgjedhura nga mbikqyresi, lehte te mirembajtura. Epoxy do te shtrihet ne te gjitha hapsirat e objektit (hyrje, koridore, klasa, laboratore, zyre) perpos kthinave sanitare ku do te punohet me pllaka porcelani. Ne kete pozicion perfshihet edhe ansoret ne lartesi 10cm ne tere perimetrin e te gjitha kthinave.	m ²	1330.00	19.5	25935.00
6.1.3	Furnizimi, transporti dhe punimi i shkalleve me gjersi 150cm ne dy anet e galerise me mveshje granit natyral (ballorja me t=2cm dhe shkelesja me t=2cm). Graniti te jete nuanca e lehte sa me I perafert me nuancen e epoxit. Ne kete pozicion perfshihet edhe shtresa nivelizuese e shkalleve me beton te thate per ngjitje te granitit. Llogaritja te behet per nr te shkalleve.	cope	52.00	55	2860.00
Pozicioni total 6.1:					42,340.00

Pozicioni total 6:	42,340.00
---------------------------	------------------

PUNËT E KERAMIKES DHE GRANITIT

PUNËT E KERAMIKES DHE GRANITIT					
7.1	PUNËT E KERAMIKES DHE GRANITIT				
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi për Njësi me TVSH/€:	Çmimi Total me TVSH/€:
7.1.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i hidroizolimit horizontal, mbi tere siperfaqet e sanitareve, me material hidroizolues me baze çimentoje , polimere e modifikuar prej dy perberesve me rrjedhshmeri te larte ekuivalente me "PLASTIVO 180", si dhe shirita elastik pergjate mureve "AQUASCUD Joint MT 25" dhe me kende te nevojshme neper qoshe, sipas projektit. Ne kalkulim te perfshihen te gjitha materialet dhe elementet e nevojshme per punimin e ketij pozicioni. Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te mbikqyresit te projektit. Mbajtje hidraulike mbi çarje prej 0,4 mm UNI EN 14891 Met. A.8.2 20 KPa (kalim uji: asgje mbas 7 diteve) Papershkueshmeria karshi ujit UNI EN 14891 Met. A.7 150 KPa (Asnje depertim uji mbas 7 diteve).	m ²	205.00	9	1845.00
7.1.2	Furnizimi, transporti dhe punimi i hidroizolimit vertikal, mbi tere siperfaqet e sanitareve (kuzhines dhe toaleteve), me material hidroizolues me baze çimentoje , polimere e modifikuar prej dy perberesve me rrjedhshmeri te larte ekuivalente me "PLASTIVO 180", si dhe shirita elastik pergjate mureve "AQUASCUD Joint MT 25" dhe me kende te nevojshme neper qoshe, sipas projektit. Ne kalkulim te perfshihen te gjitha materialet dhe elementet e nevojshme per punimin e ketij pozicioni. Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te mbikqyresit te projektit. Mbajtje hidraulike mbi çarje prej 0,4 mm UNI EN 14891 Met. A.8.2 20 KPa (kalim uji: asgje mbas 7 diteve) Papershkueshmeria karshi ujit UNI EN 14891 Met. A.7 150 KPa (Asnje depertim uji mbas 7 diteve).	m ²	145.00	9	1305.00
7.1.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave 60/60 horizontale të porcelanit (të klasit të parë) me ngjites në dysheme te toaleteve sipas skemës së projektit. Vendosja e pllakave ne dysheme te behet pa fuga (fuge prej 1 mm e lejuar). Ne llogari te meret edhe ngjitesit perkates. Llogaria të bëhet në m ² te siperfaqes se punuar.	m ²	205.00	20	4100.00
7.1.4	Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave vertikale të porcelanit 60/60 (të klasit të parë) ne muret e toaleteve deri ne lartesi 220cm me ngjites në të gjitha hapësirat e parapara në projekt. Vendosja e pllakave ne mure te behet pa fuga (fuge prej 1 mm e lejuar), . Pllakat ngjiten deri ne lartesi 220cm. Llogaria të bëhet ne m ² te siperfaqes se punuar.	m ²	362.00	20	7240.00

7.1.5	Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave vertikale të porcelanit (të klasit të parë) në muret e kuzhines dhe laboratoreve me ngjitës. Vendosija e pllakave në mure të bëhet pa fuga (fuge prej 1 mm e lejuar), lloji dhe ngjyra e pllakave caktohet sipas kërkesës së investitorit. Lartësia e vendosjes së pllakave është 160cm . Llogaria të bëhet në m ² të sipërfaqes së punuar.	m ²	210.00	20	4200.00
7.1.6	Furnizimi dhe punimi/mveshja e shkalleve në hyrjet e shkollës me panele nga Graniti Natyral klasa e parë, shkelësja me trashësi t=3cm; ballorja t=2cm,dhe pushimoret me t=1.0 cm. Pllakat duhet të jënë jo rrëshqitëse dhe rezistente ndaj ngricave. Montimi bëhet me ngjitës Ardex . Ngjyra caktohen nga sipas OM.	m ²	31.00	60	1860.00
7.1.7	Furnizimi dhe punimi/mveshja e shkalleve tek hapësira për shumë qelime në perdhese me panele nga Graniti Natyral klasa e parë, shkelësja me trashësi t=3cm; ballorja t=2cm. Montimi bëhet me ngjitës Ardex . Ngjyra caktohen nga sipas OM.	m ²	27.00	85	2295.00
7.1.8	Furnizimi dhe punimi/mveshja e hapësirave tek embrojtësit ,pushimoret e shkalleve ,coklles së shkalleve si dhe pjerrinave të brendshme me panele nga Graniti Natyral klasa e parë me t=1.0 cm, Montimi bëhet me ngjitës Ardex. . Ngjyra caktohen nga OM.	m ²	39.30	32	1257.60
Pozicioni total 7.1:					24,102.60

Pozicioni total 7:	24,102.60
---------------------------	------------------

PUNËT E FASADËS

8.1 PUNËT E FASADËS					
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi për Njësi me TVSH/€:	Çmimi Total me TVSH/€:
8.1.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i demit fasades së bardhe që përmban termoizolimit vertikal në tërë sipërfaqen e mureve të fasades së objektit, me material termoizolues Stiropor N3 me trashësi t=10cm dhe demit fasade t=3mm sipas projektit. Fasada përmban detaje të theksuara arkitektonike (pjerrtesit të vogla rreth dritareve që diktohen nga punët e vrazhta të objektit. Në kalkulim të përfshihen të gjitha materialet dhe elementet e nevojshme për punimin e këtij pozicioni (ngjitesit, bulonat perforues, rrjeta PVC me dy shtresa ngjites, rrjeta këndore në të gjitha këndet). Të gjitha punët duhet të kryhen në pajtim me projektantin dhe në udhëzim të mbikqyresit të ndërtimit.	m ²	820.00	20	16400.00

8.1.2	Furnizimi, transporti dhe punimi i demit fasades me ngjyre e lehte hiri qe permban termoizolimit vertikal ne tere siperfaqen e mureve dhe termoizolim horizontal te plafonit tek streha e erembrojtesit, me material termoizolues Stiropor N3 me trashesi t=10cm dhe demit fasade t=3mm sipas projektit. Fasada permban detaje te thjeshta arkitektonike (pjerrtesit te vogla rreth dritareve qe diktohen nga punet e vrazhta te objektit. Ne kalkulim te perfshihen te gjitha materialet dhe elementet e nevojshme per punimin e ketij pozicioni (ngjitesit, bulonat perforcues, rrjeta PVC me dy shtresa ngjites, rrjeta kendore ne te gjitha kendet). Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te mbikqyresit te ndertimit.	m ²	85.00	20	1700.00
8.1.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i izolimit termik nga themeli me stirodur 5cm deri ne pike takimin me stiropor te pozicionit 7.1.1. Stiroduri duhet te perforcohet me ngjites dhe bulona perkates, ne llogari te perfshihet edhe fondolina qe mbulon stiroduri e vendosur.	m'	135.00	8	1080.00
8.1.4	Furnizimi transporti dhe punimi i mveshjes se izolimit termik prej stiroduri ne siperfaqe nga toka deri ne kuoten 0.00 (pjesa e cokles se themelit) me perberje te fazades (zhavor I paster me ngjyre I punuar me cemento).	m'	135.00	8	1080.00
Pozicioni total 8.1:					20,260.00

Pozicioni total 8:	20,260.00
---------------------------	------------------

PUNËT E DYERVE DHE DRITAREVE

9.1 Punët e DYERVE					
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi për Njësi me TVSH/€:	Çmimi Total me TVSH/€:
9.1.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i fasades strukturale D-01 me dimensione totale 650/420 me perbajtje edhe te deres kryesore dy kraheshe te hyrjes se shkolles ne mes te fasades 180/220. Struktura është nga alumini antracid nga ana e jashtme dhe e brendshme (shtyllat e aluminit 10/8cm) dhe xham te pjes'shem dy shtresore nga 4mm (solar dhe kater sitnore) dhe dimensione totale. Ne kalkulim te perfshihen te gjitha materialet dhe elementet e nevojshme per montimin e dyerve si dhe mekanizmi i hapjes me çeles. Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te organit mbikqyres dhe skemen e deres ne projekt.	cope	1.00	4300	4300.00
9.1.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i fasades strukturale D-02 qe krijon erembrojtesin e hyrjes me dimensione totale 750/470 me perbajtje edhe te deres kryesore dy kraheshe te erembrojtesit te shkolles ne mes te fasades 180/220. Struktura është nga alumini antracid nga ana e jashtme dhe e brendshme (shtyllat e aluminit 10/8cm) dhe xham te pjes'shem dy shtresore nga 4mm (solar dhe kater sitnore) dhe dimensione totale. Ne kalkulim te perfshihen te gjitha materialet dhe elementet e nevojshme per montimin e dyerve. Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te organit mbikqyres dhe skemen e deres ne projekt.	cope	1.00	5300	5300.00

9.1.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i fasades strukturale D-03 qe rrethon hapsirat ne dy anet e erembrojtetit me dimensione totale 270/470cm dhe permbajtje brenda saj nje dere nje kraheshe 80/220 dhe dere dritare me hapje horizontale e komunikimit 60/120cm. Struktura është nga alumini antracid nga ana e jashtme dhe e brendshme (shtyllat e aluminit 10/8cm) dhe xham te pjes'shem dy shtresore nga 4mm (solar dhe kater sitnore) dhe dimensione totale. Ne kalkulim te perfshihen te gjitha materialet dhe elementet e nevojshme per montimin e dyerve. Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te organit mbikqyres dhe skemen e deres ne projekt.	cope	2.00	1900	3800.00
9.1.4	Furnizimi, transporti dhe montimi i deres teknike metalike dy kraheshe te kaldatores nga ana e jashtme me dimensione 260cm x 300cm D -04. Dera metalike duhet te jete e galvanizuar e mbrojur mire nga kushtet atmosferike kunder korrodimit si dhe e lyer me ngjyre finale antracid. Dera hapet deri ne lartesi 220cm, ndersa siper saj jane dritaret me mundesi hapje. Ne kalkulim te perfshihen te gjitha materialet dhe elementet e nevojshme per montimin e dyerve si dhe mekanizmi i mbylljes me çeles. Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te organit mbikqyres.	cope	1.00	950	950.00
9.1.5	Furnizimi, transporti dhe montimi i deres se jashtme dhe te erembrojtetit dykraheshe simetrike me dy ndarje D-05. Dyert janë nga PVC me mveshje antracid nga ana e jashtme dhe xham te pjes'shem dy shtresore nga 4mm (solar dhe kater sitnore) dhe dimensione totale 180cmx220cm. Ne kalkulim te perfshihen te gjitha materialet dhe elementet e nevojshme per montimin e dyerve si dhe mekanizmi i mbylljes me çeles. Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te organit mbikqyres dhe skemen e deres ne projekt.	cope	2.00	635	1270.00
9.1.6	Furnizimi, transporti dhe montimi i dyerve njekraheshe nga celiku i galvanizuar dhe te ngjyrosura me ngjyre te bardhe me dimensione 100 cm x 300 cm D - 06. Pjesa e deres qe hapet ka lartesine 220cm dhe eshte e pastert si material, ndersa pjesa siper eshte xham fix ne korniz celiku te njejt me kornizen e deres. Ne kalkulim te perfshihen te gjitha materialet dhe elementet e nevojshme per montimin e dyerve si dhe mekanizmi i hapjes me çeles. Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te organit mbikqyres.	cope	12.00	350	4200.00
